



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) në zbatim të nenit 50, pika 3, të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, referuar VKM-së Nr. 468, datë 3.6.2015 "Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Radio Televizioni Shqiptar tek Autoriteti i Mediave Audiovizive, të katit përdhes, katit të parë dhe të dytë të godinës me emërtimin "Atelier për dekorin e Radio-Televizionit", me qëllim inventarizimi dhe futjen në kontabilitet të vlerës së godinës (truall+ndërtesë), kërkon të rekrutojë 1 (një) ekspert të jashtëm të kualifikuar në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme tokë truall dhe ndërtesë.

TERMAT E REFERENCËS

Detyrat

- Referuar VKM-së Nr. 468, datë 3.6.2015 "Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Radio Televizioni Shqiptar tek Autoriteti i Mediave Audiovizive, të katit përdhes, katit të parë dhe të dytë të godinës me emërtimin "Atelier për dekorin e Radio-Televizionit", si dhe VKM Nr. 712, datë 12.10.2016 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e licencimit të subjekteve për ushtrimin e aktivitetit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme", eksperti do të angazhohet, në procedurën e vlerësimit të vlerës së godinës (truall + ndërtesë) ku Autoriteti i Mediave Audiovizive ushtron funksionet e saj aktualisht.
- Të përmbushë shërbimin e vlerësimit në përputhje me standartet profesionale, me kompetencë, pavarësi dhe etikë profesionale.

Periudha e zbatimit të detyrave

- Data e fillimit të zbatimit do të jetë nga nënshkrimi i kontratës nga të dyja palët. Periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 10 ditë kalendarike nga data e lidhjes së kontratës.

Kriteret për përzgjedhjen e ekspertit të jashtëm

1. Të jetë shtetas/e shqiptar.
2. Të zotërojë licencë profesionale individuale në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, ndërtesa dhe tokë truall, shkallë e parë;
3. Të ketë kryer punë të ngjashme;

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet

1. Kopje të noterizuar të licencës (Licencë në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, shkallë e parë, ndërtesa dhe tokë truall);
2. Dokumentacion që vërteton punë të ngjashme për të njëjtin objekt vlerësimi (kontrata, akt vlerësime etj).
3. Jetëshkrim/CV;
4. Dokument identifikimi (Kopje ID/Pasaportë.)

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

1. Eksperienca në punë: 70 pikë
2. Jetëshkrimi: 30 pikë

APLIKIMET MBYLLEN NË DATËN 16.06.2025, ora 11:00

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda këtij afati pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, adresa Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 15, 1010, Tiranë.